

Nisma e dldp-së për Shpërndarjen e Mësimeve dhe Përvojave në fushën e Marrëdhënieve me Publikun dhe e-Qeverisjes: Për Çfarë Bëhet Fjalë dhe Si Mund t'i Bashkoheni Kësaj Nismë!

OBJEKTIVAT

Paketa e njohurive ka si qëllim të udhëzojë NJQV-të si të përdorin në mënyrë praktike teknologjinë e informimit dhe teknikat e komunikimit, në mënyrë që të mbështetet rritja e transparencës, ofrimi i shërbimeve eficiente të orientuara nga kërkesa, përfshirja e qytetarëve në hartimin e politikave dhe vendimarrje, në linjë me strategjitet kombëtare dhe praktikat e mira.




REZULTATET E PRITSHME

Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve teknike të stafit të NJQV-së, eksposimit ndaj praktikave të mira dhe transferimit të teknologjive të menaxhimit të informacionit, pritetqë NJQV-të partnerë të arrinë një pjesë të spektrit të mëposhtëm të rezultateve :

- E-qeverisja dhe teknikat e komunikimit/informimit janë identifikuar si çështje prioritare për NJQV-të dhe është nxitur dialogu mbi politikat për këtë temë.
- Janë hartuar instrumenta për aplikimin e e-qeverisjes dhe komunikimin me publikun në nivel NJQV-je ,në linjë me objektivat e duhura kombëtare dhe rajonale .Është rritur njohja dhe përdorimi i teknikave të avancuara të komunikimit dhe i metodologjive të aplikueshme në teknologjinë e informimit nga stafi i NJQV-së.
- Stafi i NJQV-së hyn në partneritet me ofruesit e e-shërbimeve për të vënë në zbatim në mënyrë efikase nismat e informimit dhe komunikimit (të tilla si Zyra me një Ndalesë,qendra informimi, faqe interneti të dedikuara etj).
- Ofrimi i shërbimit publik është më efikas nëpërmjet zbatimit të nismave novatore në fushën e informacionit dhe komunikimit, më i orientuar ndaj kërkesave të qytetarëve dhe klientëve dhe aksesi në informacionin publik është përmirësuar.
- NJQV-të mund të mbledhin në mënyrë më efikase taksa dhe tarifa vendore, si dhe të nxisin politika dhe vendimarrje me pjesëmarrje.

METODOLOGJIA

Ofrimi i paketës së njohurive do të mundësohet nëpërmjet forcimit të kapaciteteve teknike të stafit të NJQV-së përmes trajnimit të vazhduar, bazuar nëmetodologji dhe modele të testuara zhvilluar nga dldp-ja dhe partnerët e saj. Eksposimi ndaj praktikave të mira, instrumentave dhe programeve kompjuterike të zbatueshme për funksionet e NJQV-ve të kombinuara me (bashkë) financim konkurrues të disa modeleve do të kompletojnë ciklin e ndërtimit të kapaciteteve. Ofrimi i informacionit dhe diskutimi online me anë të një platforme elektronike do të mundësojnë rrjedhën e informacionit dhe shkëmbimin brenda një rrjeti aktorësh kombëtarë, rajonalë dhe lokalë, si dhe kompanish IT dhe programesh të ngashhme.



EKSPERIENCA TË SUKSESSHME

Zyra me Një Ndalesë ka ndihmuar shumë në rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet në lidhje me diskutimet për projekt-dokumentet e politikave të tilla si buxheti afatmesëm etj. Për ta bërë këtë, ne kemi përdorur tabelat e informacionit të vendosura në kuadër të projektit Zyra me Një Ndalesë, ku janë shfaqur priorititetet. Programet e instaluara për kërkosat dhe ankesat e kanë lehtësuar shpërndarjen dhe prioritarizimin e fondeve lokale, për shembull, rekordi prej 30 ankesash në lidhje me kanalet e bllokuara të ujijtes coi në alokimin e fondeve për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi.

Koha e ofrimit të shërbimit është përmirësuar ndjeshëm: shumica e dokumenteve të kérkuara dhe të ofruara nga Zyra me Një Ndalesë jepen brenda 5-7 minutash.

Emiliana Mandi, Shefe e Zyrës me Një Ndalesë Dajç Bregu i Bunës

Adresa:

Rr. Ibrahim Rugova, Godina e "PLUS", Kat. i 2-të, nr. 3 | Tiranë | 1000 | Albania
L. Kongresi Përmjet | Rruga Oso Kukës Nr.11 | Shkodër | 4000 | Albania
www.dldp.al | www.helvetas.org | E-mail: dldp@helvetas.org

AKTIVITET KRYESORE

Përfitues të drejtëpërdrejtë janë ekspertë të administratave vendore (një numër i kufizuar nga Prefekturat dhe Qarqet) anëtarë të grupit ndër-vendorë tematik (i njohur si Qendër Kompetencë), krijuar me qëllim forcimin e kapaciteteve të administratave vendore dhe diskutimin e politikave.

Aktivitet kryesore konsiston në trajnime, vizita studimore dhe asistencë në punë. (Bashkë) financimi është i mundur për një numër të kufizuar NJQV-sh, mbi baza konkurruese. Objekti është të sigurohet që stafi dhe drejtuesit vendorë të kenë kapacitet, njohuri dhe aftesi për të kuptuar përfitimet e e-qeverisjes, pjesëmarrjes dhe komunikimit e informimit të publikut. Kësisoj përfituesit në mënyrë progresive do të përmirësojnë e përshtasin përdorimin e instrumentave të suksesshëm për çështjet e qeverisjes. Aktivitetet e planifikua përfshijnë:

- Vizita studimore që i prezantonjë pjesëmarrësit me modelet e Zyrës me Një Ndalesë (NJQV të madhësive të vogla-të mesme dhe të mëdha) dhe programet (softet) që janë në aplikim.
- Platforma diskutimipër drejtuesit dhe praktikuesit për të diskutuar mbikonceptin e Zyrës me një Ndalesë dhe për ta përmirësuat atë më tej nëpërmjet shkëmbimit dhe praktikës.
- Trajnim për ndërtimin e faqes së internetit për NJQV-të (statike dhe dinamike), rregullat dhe rregulloret e lidhura me të dhe rrjedhjen e brendshme efikase të informacionit për ndërtimin e imazhit.
- Shërbime elektronike dhe ekspozim ndaj tregut të programeve për funksionet e NJQV-së dhe mundësítë për partneritet publik-privat.
- Akses në praktika të suksesshme në fushën e qeverisjes elektronike dhe instrumentave të komunikimit zhvilluara në të gjithë vendin dhe seminarë mbi politikat për të zhvilluar kuadrin kombëtar në mbështetje të e-qeverisjes, transparencës dhe pjesëmarrjes.

ÇFARË PRITET NGA NJQV-TË PARTNERE?

- Drejtues të përkushtuar për fillimin dhe zbatimin e reformave që nevojiten për zbatimin e instrumentave të suksesshëm të komunikimit dhe e-qeverisjes, nëpërmjet allokimit të burimeve të nevojshme dhe vendim-marrjes.
- Përfshirje e drejtuesve të NJQV-së dhe stafit për të instaluar dhe për të mirëmbajtur infrastrukturën TIK (të tillë si Zyra me një Ndalesë).
- Ekspertë vendorë të gatshëm për të kapitalizuar përvojën e tyre dhe shpërndarë atë tek të tjera NJQV.
- Drejtues dhe ekspertë të gatshëm për të marrë pjesë në e-diskutimet mbi çështjet e politikave nëpërmjet platformës së menaxhimit të njohurive.
- Mbulimi i kostove të pjesëmarrjes në trajnime dhe ngjarjetematike në Shqipëri.
- Ndjejkja në mënyrë të rregullt e ngjarjeve të organzuara nga grupe i ekspertëve ndër-NJQV (Qendra e Kompetencës) për e-qeverisjen.
- Pilotimi i teknikave/instrumenteve/modaleve të sugjeruara për përdorim në NJQV dhe ofrimi i feedback-ut për përmirësimë të mëtejshme.
- Promovimi i integruar i qeverisjes së mirë përmes teknikave të komunikimit dhe e-qeverisjes Mobilizimdhë ngritje fondesh për të financuar infrastrukturën e nevojshme TIK (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit) dhe replikimin praktikave të mira të lidhura me komunikimin.

SHEMBUJ TË BURIMEVE TË MUNDSHME

Kjo paketë është pasuar me manuale dhe eksperiencia të zhvilluara në kuadër të programit të dldp-së, në partneritet me institucione kombëtare e ndërkonmbëtare, si:

- Manual për Krijimin e Zyrave me Një Ndalesë
- Manual për ndërtimin e faqes së internetit për NJQV-të
- Eksperiencia të dokumentuara të Zyrave me një Ndalesë dhe web-eve në NJQV-të e Shkodrës, Lezhës, Dajçit, Bregut të Bunës, Bushatit, Kallmetit, Shëngjinit e Velipojës
- E-qeverisje në nivel rajonal: rasti i Shkodrës e Lezhës
- Strategji për informimin e vizitorëve për zonat turistike në Shëngjin e Velipojë
- Katalog i mjeteve të informimit: praktika të mira në mbarë vendin.
- Instrumenti i Planifikimit Financiar, tarifa dhe kostoja

EKSPERIENCATË SUKSESSHME

Zyra me Një Ndalesë i ka transformuar krejtësisht marrëdhëniet tona me komunitetin, i cili tanë mendon se i respektojmë nevojat e tyre.

Zyra me Një Ndalesë na ka ndryshuar mënyrën si i bëjmë gjérat në qeverinë vendore dhe na ka lejuar të komunikojmë në mënyrë më efikase me komunitetit. Për më tepër, Zyra me Një Ndalesë dhe teknikat e komunikimit kanë forcuar marrëdhëniet tona me anëtarë të komunitetit, që jetojnë jashtë vendit. Iu shërbëjmë atyre nëpërmjet e-mailit, telefonit dhe Zyra me Një Ndalesë.

Arben Gjuraj,
Kryetar Komune Dajç Bregu i Bunës

Zyra me një ndalesë ka kontribuar ne përfornancën e Komunës Bushat në mbledhjen e taksave. Duke lehtësuar mbledhjen e taksave. Nga 37% qe ka qenë mbledhja e taksave para instalimit të zyrës me një ndalesë është rritur pëformaça në 82% pas instalimit të zyrës me një ndalesë.

Marinela Gegaj
Specialiste e tatim taksave pranë zyrës me një ndalesë në Komunën Bushat.

BËHUNI PJESË E KËTIJ PROJEKTI

Për më shumë informacion për këtë paketë njohurish, ose për të mësuar më shumë për mënyrën e pjesëmarrjes, ju lutemi kontaktoni: Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (dldp)

Adresa: Rr. Ibrahim Rugova, Godina e "PLUS",

Kati i 2-të, nr. 3, Tiranë, Shqipëri

Tel. (+355)42269225 / (+355)22250999

E-mail: dldp@helvetas.org

www.dldp.al



Adresa:

Rr. Ibrahim Rugova, Godina e "PLUS", Kati i 2-të, nr. 3 | Tiranë | 1000 | Albania
L. Kongresi Përmjet | Rruga Oso Kuka Nr.11 | Shkodër | 4000 | Albania
www.dldp.al | www.helvetas.org | E-mail: dldp@helvetas.org



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

